



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.10/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Fejzullah Rexhepi dhe Ragip Namani, anëtarë, në çështjen juridike të dënuarit F. Z., nga I., rr. “...”, sipas kërkesës për lirim me kusht, duke vendosur sipas ankesës së dënuarit, të paraqitur kundër vendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.23/23 të datës 28.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 07.04.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të dënuarit F. Z., nga I., rr. “...”, e paraqitur kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.23/23 të datës 28.02.2023.

A r s y e t i m

Paneli për Lirim me Kusht me aktvendimin PLK.D.nr.23/23 të datës 28.02.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka refuzuar kërkesën për lirim me kusht e të dënuarit F. Z., i biri i O. dhe i nënës M., e lindur M., i lindur më ..., në P., me vendbanim në I., rruga “...”, shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës. Në pikën e dytë të dispozitivit është vendosur që kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 4 (katër) muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Kundër këtij vendimi i autorizuari i të dënuarit me kohë ka paraqitur ankesë duke shprehë pakënaqësi për refuzim të kërkesës dhe duke pretenduar në zbatim të gabuar të dispozitave të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale me rastin e vlerësimit të kriterëve të përcaktuara me këtë ligj dhe marrjes së vendimit. Pastaj ka theksuar se nga momenti i fillimit të vuajtjes së dënimit i dënuari ka sjellje të mira me stafin dhe të burgosurit dhe asnjëherë nuk ka ra ndesh me rregullat e institucionit. I ka propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës ti mundësoj lirim me kusht, ashtu që të aprovoj kërkesën dhe ta liroj nga vuajtja e dënimit në atë mënyrë që t’ia kushtëzoj pjesën e mbetur të dënimit.

Me përgjigje në ankesë, Paneli për Lirim me Kusht e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e të autorizuarit të dënuarit, ka propozuar që ankesa e paraqitur të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i kundërshtuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 117 paragrafi 11 dhe 12 të Ligjit Nr. 08/L-132, për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, shqyrtoi ankesën e paraqitur nga i dënuari, vendimin e ankimuar, si dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se i dënuari F. Z., me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.120/2015, të datës 08.02.2018, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale legalizim i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe veprës penale mashtrim nga neni 261 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 23 të KPK-së, i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjet e 10 (dhjetë) muaj, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr.59/19, i datës 26.02.2019.

I dënuari përmes Institucionit të Qendrës Korrektuese ku është në vuajtje të dënimit me burg më datë 19.01.2023 ka parashtruar kërkesë për lirim me kusht, me të cilën ka kërkuar që të lirohet me kusht, me arsyetim se gjatë vuajtjes së dënimit, me sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirin e tij me kusht.

Paneli për Lirim me Kusht në seancën e mbajtur më datë 28.02.2023 pasi ka shqyrtuar kërkesën e të dënuarit, dosjen e tij, raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Shërbimit Korrektues të Kosovës, deklaratën-premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes, të njëjtën e ka refuzuar si të pa bazuar.

Në arsyetim të vendimit Paneli ka konstatuar se në trajtimin e kërkesës për lirim me kusht janë vlerësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dispozitën e nenit 14 të Rregullores nr.01/39, mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht, kushtet që parashihen në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, andaj është nxjerrë përfundimi se ende nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal i paraparë sipas dispozitës së nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Në këtë rast është marrë për bazë natyra e rëndë e veprave penale, andaj, marrë parasysh nenin 14 paragrafi 1, pika 1.1 të Rregullores nr. 01/39, ku pesha e krimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes së veprave të tilla apo të ngjashme penale, është refuzuar kërkesa e të dënuarit për periudhën kohore prej 4 (katër) muaj, që e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e ankimuar, pasi që i njëjti është në tërësi i bazuar në ligj dhe me këtë rast u pranuan si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të Panelit për Lirim me Kusht. Refuzimi i kërkesës për lirim me kusht i ushtruar nga i dënuari, është i

mbështetur në dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe në Rregulloren nr. 01/39, duke i shqyrtuar të gjitha rrethanat që parashihen me dispozitat ligjore nga ligjet e sipërcituara dhe Rregullorja nr. 01/39. Gjykata Supreme vlerëson se ende nuk janë plotësuar komulativisht të gjitha kushtet ligjore që i dënuari të përfitoj nga lirimi me kusht, kjo për faktin se ende nuk është bërë risocializimi i tij në mënyrë të plotë ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore. Përveç kësaj, kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë janë vlerësuar kriteret nga paneli marrë për bazë nenin 14 paragrafi 1, pika 1.1 të Rregullores nr. 01/39, kjo pasi që këtu kemi të bëjmë me një vepër penale të natyrës së rëndë dhe se pesha e kësaj vepre tregon për nevojën e mbrojtjes së shoqërisë përmes parandalimit të kryerjes së veprave të tilla apo të ngjashme.

Gjykata Supreme vlerëson se refuzimi i kërkesës nga ana e Panelit për Lirim me Kusht është bërë pas vlerësimit të secilit kriter të paraparë me nenin 14 paragrafi 1 pikën 1.1 të Rregullores, nr.39, mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit me Lirim me Kusht, andaj një vendim të tillë e mbështet edhe kjo gjykatë. Kjo gjykatë konstaton se refuzimi i kërkesës nuk prejudikon mënyrën e vendosjes në rast të përsëritjes së kërkesës pas kalimit të afatit prej 4 muaj, ashtu siç është përcaktuar në vendimin e panelit, andaj pretendimet ankimore të paraqitura në këtë drejtim u vlerësuan si të pabazuara.

Për arsyet e paraqitura më lart, në bazë të nenit 117 paragrafi 11, 12, të Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
AA.nr.10/2023, më 07.04.2023

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Zenel Leku